



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.818 prot.

Tiranë, më 27. 05. 2024

### V E N D I M

#### Nr. 155, datë 27. 05. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 242 Regj., datë 09.11.2023, që i përket ankuesit A. Xh., kundër Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë<sup>3</sup>, me pretendim diskriminimin për çdo shkak tjetër (për shkak të ankimit në gjykatë kundër Urdhrit të Psikologut).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, A. Xh. është pjesë e Urdhrit të Psikologut që prej krijimit të tij në vitin 2017. Për këtë ai është pajisur me licencën Nr. 15 dhe është rilicencuar në Shtator 2022, me licencë 5-vjeçare.

Me vendimin Nr. 6, datë 16.03.2023, Komisioni i Etikës së Urdhrit të Psikologut, ka vendosur përjashtimin nga urdhri i psikologut për një periudhë 6 mujore të ankuesit, A. Xh. Lidhur me këtë, ankuesi ka kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Etikës, duke iu drejtuar me ankim Presidentit të Urdhrit të Psikologut, i cili e ka lënë në fuqi aktin e nxjerrë nga Komisioni i Etikës. Sakaq, në muajin qershor 2023, pas marrjes dijani, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Urdhrit të Psikologut, ku ka kërkuar sigurimin e padisë, përmes pezullimit të ekzekutimit të aktit administrativ deri në përfundim të gjyqimit të pretendimeve të tij në themel nga organet gjyqësore.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin UP.

Në vijim, ankuesi parashtron se: “Në datën 12.08.2023 në faqen e tij zyrtare në Facebook Urdhri i Psikologut, publikon thirrjen për hapjen e trajnimit për Ekspert Vlerësues në Sistemin e Drejtësisë me afat deri në datën 25.08.2023. Në datën 18.08.2023 kam aplikuar duke bashkëngjitur dokumentet e kërkuara.

Pas aplikimit që bëra, prita për një përgjigje miratuese apo refuzuese, por nuk më erdhi një përgjigje e tillë. Nëpërmjet kolegëve që kishin aplikuar për këtë trajnim mësoj se ishin përzgjedhur dhe kishin kaluar në fazën e provimit me shkrim për trajnimin në fjalë.

Për të mësuar mbi statusin e aplikimit, i dërgova e-mail sekretarisë së UP në datën 04 Tetor 2023, por mora përgjigjen se nuk jam pranuar për shkak të: Numrit të lartë të aplikantëve dhe numrit të limituar të pjesëmarrësve në trajnim.

Theksoj se për këtë trajnim të posaçëm si Ekspert Vlerësues në Sistemin e Drejtësisë kam bërë kërkesë dhe në muajin shkurt të vitit 2021 dhe në atë kohë nuk më është kthyer një përgjigje.

Në faqen 10 të vlerësimit të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut nr. 17, datë 02.05.2023 citohet se “Trajnimi i posaçëm nuk është realizuar për shkaqe objektive (përfshi edhe pandeminë Covid-19)”.

Bëj me dije se gjatë pandemisë u zhvilluan online shumë trajnime, madje kam zhvilluar 5 (pesë) trajnime të Edukimit në Vazhdim të Akredituara nga Urdhri i Psikologut gjatë harkut kohor maj 2020 deri në korrik 2021.

Duke marrë në konsideratë faktin që, kam bërë kërkesë për trajnimin e posaçëm deri në shkurt të vitit 2021, jam pjesë aktuale e Regjistrit Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë, kam mbi 5 vjet punë në profesion me siguracione, kam vërtetime që pasqyrojnë eksperiencën në fushën përkatëse, kam mbaruar një kualifikim përkatës që është Masteri Profesional Psikologji Ligjore dhe jam bërë pjesë e Regjistrit Elektronik të Ekspertve mbi bazën e Urdhrit të Ministrisë. Të gjitha faktet e mësipërme do të ishin arsye e mjaftueshme që aplikimi im të merrej në konsideratë.

Në këto kushte unë jam diskriminuar për të marrë pjesë në Trajnimin e Posaçëm për Ekspert Vlerësues në Gjykata pasi kam kundërshtuar Vendimet e Komisionit të Etikës dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky diskriminim ka ndikuar pasi kriteri për moskryerjen e trajnimit të posaçëm si vlerësues në gjykata nga Urdhri i Psikologut është arsyeja kryesore e masës së përjashtimit prej 6-të muaj”.

Sakaq, A. Xh. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim nga ana e Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë dhe ti jepet mundësia e kryerjes së trajnimit të posaçëm si Ekspert Vlerësues në sistemin e Drejtësisë nga ana e këtij të fundit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë

*prindërore, përgjegjësine prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e subjektit ankues për diskriminim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1244/1 prot., datë 05.12.2023, i është drejtuar Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Urdhri i Psikologut përmes shkresës<sup>4</sup> nr. 732/1 prot., datë 14.12.2023, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke theksuar ndër të tjera se: *“...Psikologu A. Xh. është anëtar i Urdhrit të Psikologut me nr. 47 në Regjistrin e Anëtarësisë së Urdhrit të Psikologut si dhe është pajisur me Lejen Individuale të Ushtrimit të Profesionit (Licenca profesionale) me nr. 15 licence.*

*Institucioni ynë, pasi vlerësoi me shumë kujdes ankesën që A. Xh. ka paraqitur pranë Jush si dhe të gjithë argumentet mbi të cilat ai e ka mbështetur këtë ankesë, e gjen atë plotësisht të pabazuar në ligj dhe rrjedhimisht kërkojmë që të mos merret në konsideratë nga ana Juaj, për këto arsye:*

*Së pari, bazuar në Ligjin me Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, në nenin 20 të tij citohet se:*

1. *Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke*

<sup>4</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1244/3 prot., datë 18.12.2023.

refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

Mbështetur në sa më sipër A. Xh. si anëtar i Urdhrit të Psikologut ka të drejta e detyrime, të cilat burojnë nga parashikimet e Ligjit Nr. 40/2016 "Për psikologun në Republikën e Shqipërisë". Urdhri i Psikologut nuk i ka refuzuar në asnjë moment A. Xh. dhe askujt prej anëtarëve të tij të drejtën për të përfutuar nga shërbimet, të cilat institucioni ynë ka detyrimin ligjor për t'ia ofruar anëtarësisë së tij.

Së dyti, trajnimi objekt i këtij gjykimi, për të cilin A. Xh. ka ngritur edhe ankesën pranë institucionit Tuaj, lidhet me trajnimin e posaçëm, i cili është një prej rregullave përjashtimor, i cili duhet plotësuar me qëllim certifikimin e profesionistëve, në rastin tonë të psikologëve si ekspertë vlerësues, sanksionuar në nenin 224, pika 3 d) të Kodit të Procedurës Civile, ku citohet se:

Ministria e Drejtësisë pranon regjistrimin e ekspertit në regjistrin elektronik, nëse ai përmbush kriteret e mëposhtme:

a) të ketë dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën specifike apo të ngjashme. **Pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji është e mjaftueshme nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse;**

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë i regjistruar dhe të ketë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet në organet tatimore.

Pra sikundër mund të shihet qartësisht, trajnimi në fushën profesionale, që në këtë rast po organizon Urdhri i Psikologut, **është i vlefshëm vetëm për ata profesionistë, të cilët plotësojnë kriteret ligjore si dhe shprehin vullnetin për t'u certifikuar si ekspertë vlerësues.**

**Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se psikologu A. Xh., në momentin e aplikimit për të marrë pjesë në këtë trajnim ka qenë pjesë AKTIVE e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë,** ndaj ai sikundër të gjithë psikologët e tjerë pjesë të këtij regjistri, mund të ndjekin çfarëdolloj trajnimi tjetër, që i përket rritjes profesionale dhe specializimit të vazhdueshëm, por nuk mund të ndjekë një trajnim që ka si qëllim certifikimin e profesionistëve psikologë, në cilësinë e ekspertit, për llogari të institucioneve të drejtësisë.

Për shkak të numrit të kufizuar të psikologëve pjesëmarrës në këtë trajnim dhe duke mbajtur në konsideratë qëllimin për të cilin ky trajnim organizohet, Komisioni i Përzgjedhjes së aplikimeve për të marrë pjesë në këtë trajnim, u ka dhënë përparësi psikologëve, të cilët plotësonin kriteret ligjore si dhe shprehën vullnetin e tyre për ndjekjen e trajnimit, me qëllim certifikimin e tyre si ekspertë vlerësues dhe asistues. Për këtë arsye A. Xh., sikundër të gjithë psikologëve të tjerë, të cilët kishin aplikuar për të marrë pjesë në këtë trajnim dhe të cilët njëkohësisht ishin edhe pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, i është komunikuar në rrugë elektronike, nëpërmjet e-mail-it datë 18.10.2023, se nuk ishte përzgjedhur për të qenë pjesë e trajnimit.

Në rastin e A. Xh. kjo është një e drejtë e fituar tashmë, për shkak se ai në momentin kur ka aplikuar për të qenë pjesë e trajnimit ka qenë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, pra ai ka qenë dhe është aktualisht ekspert vlerësues pranë institucioneve

të drejtësisë, ndaj për këtë arsye ankesa e A. Xh. për mosmarrjen pjesë në këtë trajnim, jo vetëm nuk përkon me asnjë nga kriteret që lidhet me diskriminimin, bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, por mbi të gjitha kërkesa e tij për t’u bërë pjesë e këtij trajnimi është alogjike dhe e pabazuar në legjislacionin në fuqi.

Së treti, aktualisht Urdhri i Psikologut, që prej datës 3.11.2023 po zhvillon trajnimin e posaçëm për certifikimin e ekspertëve të rinj, në cilësinë e ekspertëve vlerësues dhe asistues. Në këtë trajnim marrin pjesë 18 psikologë, në modulën e trajnimit për certifikimin si psikologë asistues, 9 psikologë, në modulën e trajnimit për certifikimin si psikologë vlerësues dhe 16 psikologë do të ndjekin të dyja modulet e këtij trajnimi. Ky trajnim është parashikuar të ketë një kohëzgjatje në total prej 121 orësh. Kriteret e vendosura për të qenë pjesë e këtij trajnimi janë në mbështetje të parashikimeve të nenit 224 d) të Kodit të Procedurës Civile.

Së katërti, në lidhje me kërkesën Tuaj për informacion sa i përket faktit nëse aktualisht ka pjesëmarrës në këtë trajnim të psikologëve, të cilët janë edhe pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë, Ju konfirmojmë se të gjithë psikologët, të cilët janë përzgjedhur për të ndjekur këtë trajnim nuk janë pjesë aktive e këtij regjistri, pikërisht për arsyet e cituara sa më sipër.

Së pesti, në lidhje me kërkesën Tuaj për informacion, nëse ka patur një procedurë për përzgjedhjen e psikologëve që do të merrnin pjesë në këtë trajnim nga ana e Urdhrit të Psikologut, sqarojmë se institucioni ynë ka organizuar një procedurë të tillë, për përzgjedhjen sa më drejtë dhe objektive të psikologëve që do të merrnin pjesë në këtë trajnim. Presidenti i Urdhrit të Psikologut me anë të Urdhrit të Brendshëm Nr. 5, datë 11.09.2023, ka ngritur një Komision të vlerësimit dhe intervistimit të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve asistues dhe vlerësues në drejtësi. Kandidaturat për të marrë pjesë në këtë trajnim u janë nënshtruar disa fazave të aplikimit, siç janë intervistimet me gojë si dhe një provim me shkrim, për të bërë të mundur përzgjedhjen e kandidatëve sa më cilësorë, me qëllimin për të përmirësuar nivelin profesional të ekspertëve psikologë në të ardhmen.

Së fundmi, objektivisht është e pamundur që në një trajnim që organizohet për çfarëdolloj qëllimi të përfshihet kushdo që aplikon për të qenë pjesë e këtij trajnimi si në çdo proces tjetër të ngjashëm.

Në përfundim, mbështetur në sa më sipër kërkojmë nga Ju të mos merrni në konsideratë ankesën e A. Xh., për shkak se kjo ankesë është e pabazuar në ligj.”.

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë vuri në dispozicion të Komisionerit:

- Korrespondencën zyrtare në rrugë elektronike me A. Xh., lidhur me aplikimin për trajnim.
- Një kopje e Relacionit datë 04.08.2023, për sa i përket aplikimeve për pjesëmarrjen në trajnimin e posaçëm për ekspertë psikologë asistues dhe ekspertë psikologë vlerësues, organizuar nga Urdhri i Psikologut.
- Një kopje të Urdhrit të Brendshëm Nr. 5, datë 11.09.2023 “Për ngritjen dhe caktimin e komisionit të vlerësimit dhe intervistimit të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve asistues dhe vlerësues në drejtësi”.



- Një kopje të Procesverbalit datë 08.09.2023 të vlerësimit të dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve asistues dhe vlerësues në drejtësi.
  - Një kopje të Procesverbalit 26.10.2023 të komisionit të vlerësimit dhe intervistimit të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve asistues dhe vlerësues në drejtësi.
2. Në këto kushte, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 18.12.2023, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e Urdhrit të Psikologut. Në përgjigje të këtij e-maili A. Xh., me shkresën<sup>5</sup> datë 26.12.2023, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e tij sa i përket shkresës të sipërcituar, duke përcjell gjithashtu edhe disa dokumente shtresë.

Sa më sipër me shkresën e sipërcituar, A. Xh. theksoi ndër të tjera se: *“...Ashtu sikurse pohohet dhe nga vetë Presidentja e Urdhrit V. T. dhe nga vërtetimi elektronik i shkarkuar nga portali e-Albania, jam pjesë e Regjistrit Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë me nr. 698-E.*

*Qëndrimi se ankesa ime është alogjike dhe e pabazuar në ligj është po aq diskriminuese sa vetë procesi i ndjekur nga Urdhri i Psikologut për trajnimin e posaçëm.*

*Së pari, nisur nga pohimi i Urdhrit të Psikologut se trajnimi i posaçëm është ofruar vetëm ndaj profesionistëve të rinj, të cilët nuk janë pjesë e Regjistrit Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë nuk është korrekt pasi konstatoj se dy prej kandidatëve të pranuar nga Komisioni i Vlerësimit që ndjekin trajnimin e posaçëm janë ende pjesë e Regjistrit Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë dhe konkretisht: E. T. dhe V. H.*

*Së dyti, konstatoj se po ashtu, dy prej kandidatëve të pranuar nga Komisioni i Vlerësimit që ndjekin trajnimin e posaçëm rezultojnë të pezulluar nga Regjistri Elektronik dhe konkretisht: N. S. dhe E. K. (Fakt që nënkupton se këta dy kandidat kanë qenë aktiv përpara se të bëheshin pjesë e trajnimit të posaçëm).*

*Për të vërtetuar pohimin tim, ju ftoj të konstatoj në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke u bazuar në procesverbalin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve asistues dhe vlerësues në drejtësi. (i vënë në dispozicion nga urdhri i psikologut) dhe Regjistrin Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë. <https://www.drejtësia.gov.al/regjistri-elektronik-i-eksperteve/>.*

*Së treti, pavarësisht shpalljes së emrit tim në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve me vendim Ministri, nr. 343, datë 17.05.2021, Urdhri i Psikologut, pesë muaj më vonë, përmes shkresës me nr. 524 prot.. datë 13.10.2021, duke përmendur specifikisht emrin tim, ngre pretendimin se jam regjistruar në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve duke mos plotësuar asnjë kriter ligjor, duke nënkuptuar dhe moskryerjen e trajnimit të posaçëm të ofruar nga Urdhri Psikologut.*

*Në kthim përgjigjen e kësaj shkresë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në shkresën me nr. 5152/2, datë 08.11.2021, e ka hedhur poshtë këtë pretendim duke argumentuar se janë plotësuar kriteret ligjore nga psikologu në fjalë.*

*Theksoj se për këtë shkresë nuk jam vënë në dijeni nga Urdhri i Psikologut si anëtar i rregullt i tij dhe i prekur drejtpërdrejtë nga kërkesa për heqjen e emrit tim nga regjistri elektronik. Kjo në shkelje të plotë të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.*

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1244/4 prot., datë 29.12.2023

Së katërti, në kriteret e publikuara nga Urdhri Psikologut për t'u bërë pjesë e trajnimit të posaçëm nuk rezulton të jetë kriter përjashtues qenia në Regjistrin Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë.

Së pesti, në kthim përgjigjen e sekretares së urdhrin ndaj kërkesës sime lidhur mbi statusin e aplikimit që kisha bërë nuk më është kthyer një përgjigje e tillë sikurse në faqen nr. 2 të kthim përgjigjes së Urdhrit të Psikologut ndaj institucionit tuaj.

Së gjashti, duke filluar nga njoftimi i datës 24.02.2023 të Urdhrit të Psikologut për vënien në dijeni se ndaj meje ka nisur procedimi disiplinor nga anëtari i Komisionit Etik të Gjykimit Disiplinor Profesional, I. Ç., në faqe nr. 2 të këtij njoftimi citohet se “Ai nuk ka kryer trajnimin profesional”.

Gjithashtu dhe në faqen 6, pika 7 të vendimit nr. 6, datë 16.03.2023 citohet se “Psikologu A. Xh. nga verifikimet rezulton se nuk ka trajnimin e Posaçëm në fushën e Drejtësisë”.

Bazuar në procedurën e Urdhrit të Psikologut ndaj meje, me arsyetimin kryesor se nuk kam kryer trajnimin e posaçëm, është marrë masa disiplinore **“Përjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”**.

**Për arsye se: 1. Është konstatuar shkelja e standardeve 2.01 “Kufijtë e Kompetencës” germat a), c), ç), d), dhe standardit 3.04 “Shmangia e dëmit” germat a) dhe b) të Kodit të Etik dhe Deontologjik të Psikologut.**

Për të qartësuar me tepër lidhjen e mos kryerjes së trajnimit të posaçëm me masën disiplinore të marrë ndaj meje po citoj saktësisht germat përkatëse të standardit të përmendur.

a) Psikologët ofrojnë shërbime, japin mësim dhe kryejnë kërkime shkencore në popullata vetëm në ato fusha që janë brenda kufijve të kompetencave të tyre, bazuar në arsimimin, trajnimet, eksperiencat e supervizuara, konsultimet, studimet ose përvojat e tyre profesionale. Psikologët nuk duhet të ushtrojnë kompetenca jashtë fushës së tyre, të cilat lidhen me disiplina të tjera si p.sh: sociologji, punë sociale, mjekësi, etj.

Referuar kësaj germe, shkelje e kufijve të kompetencave konsiderohet ofrimi i shërbimeve të cilat lidhen me disiplina të tjera si p.sh: sociologji, pune sociale, mjekësi, etj.

Theksoj se kam ofruar shërbime psikologjike në Sistemin e Drejtësisë bazuar në licencën Psikolog Klinik me nr. 15 dhe arsimimin shtesë brenda disiplinës së psikologjisë - Master Profesional Psikologji Ligjore.

b) Kur dija profesionale dhe shkencore në disiplinën e psikologjisë përcakton se kuptimi i faktorëve që lidhen me moshën, gjininë, identitetin gjinor, racën, etninë, kulturën, origjinën kombëtare, besimin, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar, gjuhën ose statusin socio ekonomik është thelbësor për zbatimin efektiv të shërbimeve apo kërkimit të tyre, psikologët duhet të trajnohen, të marrin eksperiencë, të marrin konsultime ose supervizim të nevojshëm për të qenë kompetente në shërbimet që ofrojnë, përveç rasteve të parashikuara në Standardin.

c) Psikologët që planifikojnë të ofrojnë shërbime, të japin mësim ose të kryejnë kërkime që përfshijnë popullata, fusha, teknika ose teknologji të reja për ta, duhet të marrin edukimin përkatës, trajnimin, supervizimin, eksperiencën, konsultimin apo studimin e nevojshëm.

d) Kur psikologëve u kërkohet të sigurojnë shërbime për individë, për të cilët shërbimet përkatëse të shëndetit mendor nuk janë të mundshme dhe vetë psikologët nuk kanë kompetencat e nevojshme, me qëllim që të mos u mohohen shërbimet atyre që kanë nevojë, psikologët, që kanë

*trajnim ose eksperiencë të përfaqshme, mund të ofrojnë shërbime të tilla, por ata duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të fituar kompetencat e nevojshme nëpërmjet kërkimit, trajnimit, konsultimit ose studimit përkatës.*

*Ndërsa përta i përket fushës së kompetencave gjithashtu Urdhri i Psikologut me anë të shkresës nr. 500 prot., datë 02.09.2022 nëpërmjet të së cilës kërkohet bashkëpunimi i Urdhrit me Ministrinë e Drejtësisë për moslejimin e regjistrimit në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve të cilët nuk kanë fushën e kompetencës bazuar në njërën prej profileve si vijon:*

- 1- Psikologji Ligjore*
- 2- Psikologji Juridike*
- 3- Psikologji Klinike*
- 4- Psikologji Forensike*

*Në përputhje me gërmat e cituara të nenit 2.01 të Kodit të Etikës “Kufijt e kompetencave”, dhe fushave të kompetencave të vetë kërkesës që ka bërë Urdhri ndaj Ministrisë së Drejtësisë deklarohet se jam bërë pjesë e Regjistrat Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë bazuar në arsimimin, edukimin, kualifikimin përkatës që është Masteri Profesional Psikologji Ligjore dhe përvojave profesionale të vërtetuara tashmë, gjithashtu duke bërë kërkesë për trajnimin e posaçëm deri në muajin shkurt 2021 dhe aplikim në muajin Gusht 2023.*

*Këtë vendim të Komisionit të Etikës, i lënë në fuqi nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut e kam ankimuar në Gjykatën Administrative, Tiranë dhe jam duke zhvilluar gjyqin në themel të tij dhe ende jam pjesë e Regjistrat Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë pasi vendimet e Urdhrit të Psikologut janë pezulluar me sigurim padie të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me vendim të datës 16.06.2023.*

*Së shtati, urdhri i brendshëm për ngritjen e Komisionit të vlerësimit dhe Intervistimit të kandidatëve dhe caktimin e N. B. dhe B. T. si anëtarë të komisionit është dhënë në datën 11.09.2023, ndërsa procesverbali i Komisionit të Vlerësimit të dosjeve të kandidatëve mban datën 08.09.2023.*

*Kjo renditje datash pasqyron se anëtarët e komisionit kanë nxjerrë më parë përfundimet e shqyrtimit të dosjeve pa marrë zyrarisht detyrën.*

*Së treti, pavarësisht mospërputhjes së mësipërme, Komisioni i Vlerësimit të dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve vlerësues në drejtësi pasqyron emrin tim me nr. rendor 36- A. Xh. me vite pune 7.7 dhe Vlerësimin- Kalon. (faqja 3 e procesverbalit të vlerësimit të kandidatëve).*

*Por edhe pse aplikimi im është pranuar nga komisioni, nuk jam thirrur për fazat e mëtejshme por jam njoftuar se për shkak të numrit të lart të aplikimeve dhe numrit të limituar të pranimeve nuk jam përzgjedhur.*

*Së fundmi, duke pasur në konsideratë objektin që jam proceduar, Urdhri i Psikologut përmes shkresës me nr. 340 prot. të datës 14.06.2023, i është drejtuar gjykatave të vendit me kërkesën që të mos më thërrasin në proceset e tyre. (faqja 2, renditja nr. 5).*

*Për këtë shkresë të Urdhrit të Psikologut kam kërkuar informacion nga drejtoria përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë dhe nëpërmjet adresës elektronike zyrtare të Regjistrat Elektronik më është kthyer përgjigja: “Sa më sipër, në kushtet kur gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën tuaj për sigurim padie, me qëllim pezullimin e efekteve të vendimit të dhënë me nr. 17, datë 02.05.2023 nga*



*Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, ju bëjmë me dije se Ministria e Drejtësisë nuk do të fillojë procedurën e pezullimit tuaj në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve, deri në një vendimmarrje tjetër nga ana e gjykatës lidhur me sigurimin e padisë apo çështjen e themelit”.*

*Si përfundim, bazuar në arsyetimet e mësipërme dhe provat e bashkëngjitura kërkoj nga institucioni juaj të merrni në konsideratë ankesën e bërë prej meje ndaj Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.*

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 252 prot., datë 06.02.2024, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, duke iu bërë të ditur se, secila prej tyre mund të depozitojë gjatë seancës, shpjegime si dhe dokumentacion provues në favor të argumenteve të veta.

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 22.02.2024, me praninë e subjektit ankues personalisht dhe përfaqësuesit me autorizim<sup>6</sup> të Urdhrit të Psikologut, I. Ç., me detyrë Jurist.

Pala ankuese u qëndroi të njëjtave pretendime si ato të bëra të njohura shkresërisht në ankesën e parashtrimit e depozituara prej saj para KMD-së, duke shtuar ndër të tjera se asnjë nga personat që janë pezulluar nga UP nuk i është pranuar kërkesa për tu bërë pjesë e trajnimit të posaçëm. Sipas tij, diskriminimi ka ndodhur kolektiv.

Në vijim, përfaqësuesi i UP theksoi se: *“...ky trajnim është i posaçëm, se e ka ligji që është i posaçëm, ka kritere të specifikuar në ligj, por edhe po mos të ishte një trajnim i posaçëm, por një trajnim i çfarëdoshëm, nuk gjej asnjë arsye ligjore, por edhe logjike, sepse këtu për ligj nuk bëhet fjalë, përse kohë dhe nga pala ankuese, nuk u përcaktua një germë e ligjit të diskriminimit që është prekur... Trajnimi është i posaçëm dhe këtë e vendos ligji, është Kodi i Procedurës Civile, neni 224/3/d. Gjykata Administrative e Tiranës, nuk është shprehur ende, lidhur me vendimet e organeve të UP, të komisionit të etikës, këshillit kombëtar, për masat disiplinore që janë dhënë, jo vetëm ndaj A. Xh., por edhe psikologëve të tjerë. Dua të saktësoj që kjo është një fushatë e ndërmarrë me gjithë psikologët dhe nuk ka lidhje me plotësimin e kritereve ligjore dhe me Ministrinë e Drejtësisë, sepse në rast se do ishte e tillë, në situatën gjyqësore nuk do ta kishim me psikologun, do ta kishim me ministrinë. Por ky është konfondim që i bëjnë më keqdashje psikologët tanë, që thonë që urdhri ka dalë mbi kriteret e ministrisë, ndërkohë që urdhri ka mision ligjor për të gjykuar kompetencat profesionale jo ligjore. Nuk i është thënë askujt që ti je regjistruar gabim. Situata faktike është që, këta janë pjesë e regjistrit elektronik të Ministrisë së Drejtësisë...”*

*UP ka paraqitur dhe provat, në shkresën 732/1, datë 14.12.2023, lidhur me procedurën e ndjekur nga UP për të selektuar psikologët që të jenë pjesë e këtij trajnimi. Patjetër që numri është i kufizuar dhe kuptohet për çështje logjistike financiare. Si A. Xh., trajnimitin e kanë kërkuar shumë persona të tjerë, jo vetëm A. Xh....*

*Arsyeja që vjen ankesa këtu dhe thuhet që është për shkak të ankimit, nuk është absolutisht e vërtetë se nuk është e bazuar në asnjë fakt, asnjë provë. Si A. Xh., me ankim në gjykatë janë në mos*

<sup>6</sup> Nr. 110 prot., datë 21.02.2024

gaboj, 12 psikologë të tjerë. Asnjë prej atyre nuk ka marrë pjesë në trajnim. Asnjë nga psikologët e regjistrir elektronik nuk ka marrë pjesë në trajnim. Me të drejtë këtë që A. Xh. tha, që janë 2 apo 3 persona që janë aktivë sot. UP, i është drejtuar me shkresë MD për të kuptuar arsyet. Në momentin që janë bërë kriteret e përzgjedhjes, këta psikologë nuk kanë qenë aktivë në regjistër dhe ka ardhur përgjigja, mund t'i vë në dispozicion në një moment patjetër që specifikon datën kur është mbyllur. Të qenit status aktiv i këtyre personave, ato e kanë rihapur dhe mbajnë përgjegjësi pse kanë hapur, pasi janë përfshirë në trajnim. Por nuk është i vërtetë fare fakti që ne i kemi futur, kemi përfshirë në trajnim dhe ato kanë qenë aktivë në regjistër, kjo është e pavërtetë. Për këtë mund ta vendosim në dispozicion shkresën e MD, që e vërteton diçka të tillë, patjetër...

Kështu që diskriminim brenda grupit nuk kemi. Diskriminim edhe me regjistrin elektronik me anëtarët e tjerë që janë, në mos gaboj, edhe 60 e ca psikologë, që janë në pjesë të regjistrir nuk kemi, sepse asnjë prej tyre nuk është pjesë e trajnimit...

Ministrisë së Drejtësisë i vjen një aplikues shikon kriteret ligjore të nenit 224/3/d të K. Pr. Civile dhe vendos ta regjistrojë ose jo një psikolog. Por psikologu ka detyrime dhe karshi UP ose organit profesional, se ka detyrime të kompetencës profesionale...

Po të jemi marrë me kriteret ligjore, sot do të ishim në përballje gjyqësore me ministrinë, jo me psikologët. Këtë kemi sqaruar gjithmonë, edhe në prapësime e keni...

Fakti është që një grup psikologësh janë pjesë e regjistrir, prandaj ne jemi në përballje gjyqësore, sepse mendojmë që nuk duhet të jenë për arsye se nuk i plotësojnë kriteret, 10 vite nuk i kanë me dokumente dhe nuk kanë trajnimin e posaçëm..."

4. Në vijim të seancës dëgjimore, përmes shkresës<sup>7</sup> nr. 137 prot., datë 01.03.2024, Urdhri i Psikologut, përcolli pranë Komisionerit parashtrime shtesë, duke theksuar ndër të tjera se:

"1. Në lidhje me pretendimin e ngritur nga pala ankuese A. Xh. në seancë dëgjimore, se Urdhri i Psikologut ka përfshirë në trajnimin e posaçëm edhe psikologë, të cilët kanë qenë të regjistruar me statusin aktiv në Regjistrin e Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, sqarojmë se ky pretendim nuk qëndron pasi, Ju informojmë konkretisht se psikologia znj. Veliona Hoxhaj pas komunikimeve me këtë ministri, jemi vënë në dijeni se statusi i saj në regjistër është pezulluar më datë 28.09.2023, ndërkohë psikologia znj. Elona Toçaj na ka vënë në dijeni nëpërmjet e mail-it në adresën sekretaria@urdhriipsikologut.al, datë 24.10.2023, për pezullimin e saj nga Regjistri Elektronik i Ekspertëve të kryer nga Ministria e Drejtësisë po në datë 24.10.2023.

Në këtë mënyrë, sqarojmë se rezulton se të dyja këto psikologe në momentin e përzgjedhjes së Urdhrit të Psikologut për trajnimin e posaçëm nuk kanë patur statusin aktiv në këtë regjistër, në kundërshtim me pretendimin e ankuesit. Për më shumë informacion, apo në lidhje me psikologë të tjerë, të cilët kanë qenë pjesë e këtij trajnimi, sa i përket regjistrimit të tyre në këtë regjistër, lutemi t'i drejtoheni Ministrisë së Drejtësisë, si institucioni përgjegjës që administron Regjistrin Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Në lidhje me pretendimin e ngritur nga pala ankuese A. Xh. se Urdhri i Psikologut ka përfshirë në trajnim psikologë, të cilët sikundër edhe A. Xh. kanë investuar Gjykatën Administrative, me ngritjen e padisë kundrejt Urdhrit të Psikologut, në lidhje me marrjen e masave

<sup>7</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 384 prot., datë 04.03.2024

*disiplinore ndaj tyre, të dhëna nga organet e Urdhrit të Psikologut, sqarojmë se ky pretendim është jo i vërtetë, pasi aktualisht ndaj Urdhrit të Psikologut janë ngritur padi me të njëjtin objekt, sikundër edhe padia e palës ankuese A. Xh., këta psikologë:*

- A. K.
- A. I.
- A. M.
- A. Xh.
- B. N.
- D. M.
- E. P.
- N. L.

*Mbështetur në sa më sipër ju mund të verifikoni lirisht në listën e psikologëve pjesëmarrës në trajnim, se asnjë prej psikologëve të sipër shënuar nuk ka marrë pjesë në trajnimin e posaçëm të zhvilluar nga Urdhri i Psikologut.”*

5. Në vijim, përmes e-mail-it datë 07.03.2024, Komisioneri i përcolli ankuesit parashtrimet e Urdhrit të psikologut.

Në përgjigje të e-mail-it të sipërcituar A. Xh. nuk vuri në dispozicion të Komisionerit parashtrime shtesë.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “ “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë

*informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun IV, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 20, ku përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

*a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

*b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

*2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:*

...

*g) shërbimet e profesioneve të lira.*

....

...

*4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit...”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi në gëzimin e të drejtës për të përfituar të mira dhe shërbime, duke përfshirë shërbimet e profesioneve të lira.*

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi nga Urdhri i Psikologut.**

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, rezultojnë të provuara faktet e mëposhtme:

Ankuesi, A. Xh., është me profesion psikolog dhe është anëtar i UP. Është licencuar si “Psikolog Klinik” dhe është e pajisur me Licencë Nr. 15, lëshuar në datën 01.09.2017 dhe rilicencuar më datë 02.09.2022 nga UP. Me Urdhrin Nr. 343, datë 17.05.2021, ankuesi është bërë pjesë e ekspertëve psikologë, në Regjistrin Elektronik Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë.

Profesioni i psikologut rregullohet në bazë të ligjit të posaçëm nr. 40/2016 *“Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”* (në vijim ligji nr. 40/2016). Në bazë të nenit 7, pika 1, të

ligjit nr. 40/2016, parashikohet se: “1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e psikologut, në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm.”

Në nenin 9, të Statutit të UP, përcaktohet: “1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e psikologut në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm. 2. Punëdhënësit e institucioneve publike dhe private ndalohen t'i punësojnë psikologët në kundërshtim me këtë dispozitë.”

Regjistri Elektronik i Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë, i cili mbahet në format elektronik, grupon ekspertët sipas fushës së tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata punojnë, referuar juridiksionit territorial të rretheve gjyqësore. Ky regjistër është krijuar dhe administrohet nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Drejtësisë nr. 10619, datë 19.10.2018 “Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrimit Elektronik për Ekspertët”, të ndryshuar. Referuar pikës 5, të Kreut I, të udhëzimit të sipërcituar, përcaktohet se: “Në regjistrin Elektronik të ekspertëve regjistrohen ekspertët që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- i. të ketë zotësi për të vepruar;
- ii. të ketë dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën specifike apo të ngjashme ose pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji, nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse;
- iii. të jetë i regjistruar dhe të ketë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet në organet tatimore;
- iv. ....
- v. të jetë i pajisur me licencën profesionale përkatëse sipas fushës së ekspertizës për të cilën paraqet kërkesë për regjistrim.”

Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 224, “Regjistri i elektronik i ekspertëve”, parashikon se:

“1. Ministria e Drejtësisë krijon, administron dhe vë në dispozicion për publikun një regjistër elektronik për ekspertët. Ky regjistër ndahet në seksione të ndryshme, duke grupuar ekspertët, sipas fushave të tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata punojnë.

2. Gjyqtari cakton një ekspert jashtë regjistrimit elektronik, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre.

3. Ministria e Drejtësisë pranon regjistrimin e ekspertit në regjistrin elektronik, nëse ai përmbush kriteret e mëposhtme:

a) të ketë dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën specifike apo të ngjashme. Pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji është e mjaftueshme nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë i regjistruar dhe të ketë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet në organet tatimore.



*4. Regjistri elektronik duhet të parashikojë një rubrikë të veçantë, ku palët e interesuara mund të vlerësojnë ekspertin në lidhje me ekspertizat e tij në të shkuarën, duke përdorur një sistem pikëzimi.”*

Referuar informacionit të administruar bazuar në Vendimin Nr. 1, datë 03.02.2023, të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, është rekomanduar nisja e procedurës disiplinore, rast pas rasti, për ata psikologë, pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve, për të cilët konstatohet tejkalim i fushës së kompetencës, mosrespektim i Urdhrave dhe Rregulloreve të Urdhrit të Psikologut, mungesë e bashkëpunimit, si dhe, potencialisht, mundësia e shkakutimit të dëmit të publiku të cilit i ofrojnë shërbime.

Objekt i shqyrtimit nga Komisioni ka qenë kategoria e psikologëve, pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë, të cilët nuk plotësojnë kriteret profesionale në lidhje me fushën e kompetencës, duke mos patur 10 vite eksperiencë në fushë, si dhe duke mos i'u nënshtruar trajnimit të posaçëm, të zhvilluar nga Urdhri i Psikologut në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë në fushën e Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 224, pika 3/d) të Kodit të Procedurës Civile.

Me vendimin Nr. 6, datë 16.03.2023, Komisioni i Etikës së Urdhrit të Psikologut, ka vendosur përjashtimin nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 mujore ankuesin, A. Xh., me arsyetimin se nuk provonte eksperiencën mbi 10 vite në fushë, si dhe nuk kishte kryer trajnimin e posaçëm të ofruar nga Urdhri i Psikologut në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Lidhur me këtë, ankuesi ka kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Etikës, duke iu drejtuar me ankim Presidentit të Urdhrit të Psikologut, i cili e ka lënë në fuqi aktin e nxjerrë nga Komisioni i Etikës.

Rezulton se Komisioni i Etikës së UP-së, gjatë shqyrtimit të dosjeve të psikologëve që ishin pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve ka konstatuar se nuk plotësojnë kriteret për tu bërë pjesë e regjistrimit edhe 12 psikologë të tjerë. Në këto kushte, sipas parashikimeve të bëra nga palët gjatë seancës dëgjimore, rezulton se, veç ankuesit Urdhri i Psikologut ka marrë të njëjtat masa disiplinore edhe ndaj 12 psikologëve të tjerë që janë gjendur në kushtet e mosplotësimit të kriterëve si në rastin e A. Xh..

Neni 21 i ligjit nr. 40/2016 *“Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”* dhe neni 39 i Statutit të Urdhrit të Psikologut parashikojnë se *“1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i paraqiten Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit. 2. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës merr në shqyrtim ose ngrë një komision ad hoc dhe jep vendimin për ankesën e paraqitur 3. Vendimi i Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi”.*

Në vijim, masa disiplinore e A. Xh. është marrë në shqyrtim nga ana e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, i cili me vendimin Nr. 17, datë 02.05.2023, ka rrëzuar kërkesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Vendimin Nr. 6, datë 16.03.2023, të Komisionit Etik e Gjykimin Disiplinor Profesional të UP. Referuar Procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të UP, më datë 02.05.2023, evidentohet se Këshilli ka marrë në shqyrtim dhe ka lënë në fuqi vendimet e Komisionit të Etikës, veç

ankesës së A. Xh. edhe ankesat e 4 (katër) psikologëve të tjerë ndaj të cilëve ishin marrë masa disiplinore si në rastin e ankuesit.

Sakaq, në muajin qershor 2023, pas marrjes dijeni, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Urdhrit të Psikologut, ku ka kërkuar sigurimin e padisë, përmes pezullimit të ekzekutimit të aktit administrativ deri në përfundim të gjykimit të pretendimeve të tij në themel nga organet gjyqësore.

Në këtë situatë, duke qenë se A. Xh. ka bërë pjesë të kërkesë padisë së paraqitur në organet gjyqësore vendimmarrjen e Urdhrit të Psikologut, Komisioneri do të vijojë me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë që lidhen me mospranimin e ankuesit në trajnimin e posaçëm të organizuar nga UP.

Lidhur me sa më sipër, në datën 12.08.2023, ankuesi është njohur me njoftimin e Urdhrit të Psikologut të publikuar në faqen e zyrtare në Facebook, për hapjen e trajnimit për Ekspert Vlerësues në Sistemin e Drejtësisë me afat deri në datën 25.08.2023. Njoftimi në faqen e Facebook, por edhe në web faqen e UP, bënte publike thirrjen për ekspertë vlerësues në sistemin e drejtësisë, duke cituar se: *“Të gjithë psikologët që dëshirojnë të bëhen pjesë e sistemit të drejtësisë në cilësinë e psikologut vlerësues, duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:*

*1-Të jenë anëtarë aktivë dhe të licencuar nga Urdhri i Psikologut;*

*2- Të kenë një nga profilet e mëposhtme:*

*\* Psikologji ligjore*

*\* Psikologji juridike*

*\* Psikologji forensike*

*\* Psikologji klinike*

*3- Të kenë minimalisht 5 (pesë) vite eksperiencë profesionale në fushë;*

*4- Të mos jenë të dënuar penalisht;*

*5- Të mos jenë të ndëshkuar me masë disiplinore nga organet e Urdhrit të Psikologut në 3 (tre) vitet e fundit;*

*6- Të ushtrojnë profesionin dhe të kenë vendbanimin në qarqet: Dibër, Vlorë, Kukës, Lezhë, Durrës, Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Elbasan, Korçë dhe Berat.*

*Të gjithë psikologët e interesuar të aplikojnë në linkun: <https://www.urdhriipsikologut.al/aplikim-per-eksperte.../>”.*

Referuar informacionit të publikuar nga ana e UP në faqen e Facebook, më datë 16.08.2023, njoftoheshin të gjithë personat që kishin aplikuar për tu bërë pjesë e trajnimit, se: *“Nisur nga interesi dhe pyetjet që i janë drejtuar Urdhrit të Psikologut në lidhje me trajnimin për asistues dhe vlerësues në sistemin e drejtësisë, Ju sqarojmë se numri i pjesëmarrësve në trajnim do të jetë i limituar me qëllim ruajtjen e standardeve dhe cilësisë së trajnimit. Për këtë arsye të gjithë aplikantët do t’i nënshtrohen disa fazave të vlerësimit siç Ju kemi bërë me dije edhe në njoftimin për hapjen e aplikimit. Urdhri i Psikologut do të vijojë me ofrimin e këtij trajnimi edhe në të*

*ardhmen në përputhje me nevojat që do të ketë sistemi i drejtësisë për ekspertë asistues dhe vlerësues!”.*

Përmes e-mail-it datë 18.08.2023, ankuesi ka aplikuar duke bashkëngjitur dokumentet e kërkuara. Pas aplikimit të bërë, ankuesi nuk ka marrë asnjë informacion lidhur me përzgjedhjen ose jo të tij nga UP për të qenë pjesë e trajnimit. Sipas tij, ai ka marrë dijeni përmes kolegëve se UP kishte filluar përzgjedhjen e kandidatëve dhe kishin kaluar në fazën e provimit me shkrim për trajnimin në fjalë.

Për të mësuar mbi statusin e aplikimit, ankuesi i është drejtuar me e-mail Urdhrit të Psikologut, më datë 04.10.2023. Në përgjigje të e-mailit të tij, më datë 18.10.2023, Sekretaria e Urdhrit të Psikologut ka njoftuar ankuesin duke i sqaruar se aplikimi i tij nuk ka kaluar me sukses në fazat e mëtejshme për shkak të: Numrit të lartë të aplikantëve dhe numrit të limituar të pjesëmarrësve në trajnim.

Pavarësisht përgjigjes së kthyer nga ana e Urdhrit të Psikologut, ankuesi ka pretenduar pranë Komisionerit se shkak përse ai nuk është përzgjedhur nga UP për të ndjekur trajnimin e posaçëm është fakti që ai i është kundërshtuar Vendimet e Komisionit të Etikës dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Mbështetur në Procesverbalin e komisionit të vlerësimit të dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve asistues dhe vlerësues në drejtësi, i cili mban datën 08.09.2023, rezulton se kanë kaluar në fazën e vlerësimit referuar kritereve të shpallura, 70 (shtatëdhjetë) kandidatë/aplikantë, nga të cilët 47 (dyzet e shtatë) prej tyre janë kualifikuar në fazën e testimit me shkrim.

Në këtë trajnim të posaçëm sipas informacionit të administruar dhe të gjendur në Procesverbalin e komisionit të vlerësimit të dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar për trajnimin e ekspertëve asistues dhe vlerësues në drejtësi, i cili mban datën 26.10.2023, rezulton se janë kualifikuar për të marrë pjesë në trajnim pas përfundimit fazës së testimit me shkrim dhe intervistave, si më poshtë:

- 12 psikologë Asistues;
- 6 psikologë Vlerësues;
- 11 psikologë Asistues + Vlerësues.

Sipas pretendimeve të subjektit ankues, pavarësisht faktit që në trajnimin e posaçëm thirrshin kandidatët psikologë që dëshironin të bëheshin pjesë e ekspertëve të sistemit të drejtësisë, pjesë e trajnimit ishin bërë edhe psikologë të cilët ishin pjesë tashmë e Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve. Pra sipas tij, ai nuk është përzgjedhur të jetë pjesë e trajnimit nga UP, pasi ka kundërshtuar në gjykatë masën disiplinore të dhënë ndaj tij nga ana e Këshillit Kombëtar të UP-së.

Nga informacioni i administruar, gjatë seancës dëgjimore por edhe pas saj, rezultoi që pjesëmarrës në trajnim nuk ishte bërë asnjë psikolog që ishte pjesë e Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve. Edhe pse nga ana e ankuesit u pretendua se kishte kandidatë të cilët ishin bërë pjesë e trajnimit pavarësisht se ishin pjesë edhe e Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve, një fakt i tillë nuk u provua nga çfarë u administrua gjatë procedurës hetimore.

Nga provat e administruara u konstatua se në momentin e aplikimit për të qenë pjesë e trajnimit të posaçëm, rezultonin që kandidatë që më parë kanë qenë pjesë e Rregjistrimit Elektronik, kishin pezulluar statusin e tyre në këtë regjistër dhe kjo ishte një ndër arsyet pse ishin bërë pjesë e trajnimit.

Sa më sipër, rezulton se, ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me kandidatët e tjerë të cilët ndodheshin në kushte të njëjta me të sa i përket aplikimit për trajnimin e posaçëm për ekspert pranë institucioneve të drejtësisë. Nga informacioni i administruar nuk rezultoi se ndonjë prej psikologëve të kualifikuar në trajnimin e posaçëm të ishte pjesë aktive e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve, sikur ankuesi. Gjithashtu, nga provat e administruara rezultoi se edhe psikologët e tjerë të cilët kishin paraqitur ankim në gjykatë sa i përket masave disiplinore të marra ndaj tyre nga ana e UP, nuk ishin bërë pjesë e Urdhrit të Psikologut me arsyetimit se ata tashmë kanë qenë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve.

Nga analiza e fakteve të administruar, rezulton se trajnimi i posaçëm për ekspert pranë institucioneve të drejtësisë, realizohej nga ana e Urdhrit të Psikologut për tu bërë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve. Përsa kohë që psikologët kanë qenë pjesë e tij, nuk lindte nevoja për tu bërë pjesë e trajnimit të posaçëm të zhvilluar nga ana e Urdhrit të Psikologut. Pavarësisht këtij fakti, rezultoi se numri i pjesëmarrësve në trajnimin e posaçëm ishte i limituar, referuar psikologëve të kualifikuar dhe njoftimit të bërë nga ana e Urdhrit të Psikologut të bërë publik përpara përfundimit të afateve për dorëzimin e dokumentacionit.

Neni 7 i LMD-së<sup>8</sup>, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave nuk rezultoi se ankuesi është vendosur në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme nga ana e Urdhrit të Psikologut sa i përket pjesëmarrjes në trajnimin e posaçëm për ekspert vlerësues në sistemin e drejtësisë, krahasuar me psikologë të tjerë të cilët ndodhen në kushte të njëjta me të.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, nga ana e Urdhrit të Psikologut në Republikën e

<sup>8</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Shqipërisë, lidhur me mos kualifikimin e ankuesit në trajnimin e posaçëm për ekspert vlerësues në sistemin e drejtësisë. Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të subjektit ankues, A. Xh., në të drejtën për tu bërë pjesë e trajnimit të posaçëm për ekspert të sistemit të drejtësisë, nga ana e Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, për shkakun e pretenduar prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Për shkak të kundërshtimit të vendimi të UP)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)